

Një informacion përmbledhës: përmbajtja e MSA, linjat e përgjithëshme të Interim Agreement.

Marrëveshja e stabilizim asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, tashmë e parafuar dhe e gatëshme për firmosjen përfundimtare u zhvillua në një proces të gjatë i cili zgjati mbi 2 vjet, duke kalur në rreth 12 raunde bisedimesh teknike dhe 3-4 raunde bisedimesh politike.

Marrëveshja e stabilizim asociimit do të hyjë në fuqi pas ratifikimit të saj nga Kuvëndi i Shqipërisë dhe të 25 vëndet anëtare të Bashkimit Europian, brënda një periudhe 2 vjeçare nga data e nënshkrimit, pasi kjo lloj marrëveshje është kompetencë e parlamenteve të t 25 vëndeve anëtare.

Ndërkohë nga kjo marrëveshje veçohet pjesa e lëvizjes së lirë të mallrave, pasi kompetencat e miratimit të saj janë të Bashkimit Europian, si të tilla nga ana e Bashkimit Europian ato hyjnë në fuqi menjëherë me firmosjen e saj, ndërkohë që kërkojnë edhe ratifikimin e saj në Kuvëndin e Republikës së Shqipërisë.

Ku mbështetet marrëveshja e stabilizim asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, çfarë përmban ajo dhe cilat janë synimet e saj.

Marrëveshja e stabilizim asociimit mbështetet në nenin 310 të Traktatit të Bashkimit Europian, i cili lejon lidhjen e marrëveshjeve të tilla, me parimet themelore:

- (i) detyrime dhe të drejta reciproke ndërmjet vëndeve të Bashkimit Europian dhe vëndit të asociuar;
- (ii) veprime të përbashkëta dhe
- (iii) procedura specifike.

Si e tillë kjo lloj marrëveshje konsiderohet si, citoj vëndimin e Gypatës Europiane të Drejtësisë: **“një mjet që krijon lidhje speciale dhe të privileguara të vëndeve të treta me Bashkimin Europian, të cilat nga ana e tyre marrin pjesë në sistemin komunitar. Nga ana tjetër, Komuniteti Europian, bazuar edhe në nenin 310 duhet të garantojë marrjen e masave për të gjitha fushat që mbulon traktati.”**

Çfarë synon procesi i asociimit të një vëndi me Bashkimin Europian, pra cilat janë parimet bazë dhe qëllimi përfundimtar?

- ✚ Forcimi i demokracisë dhe sundimi i të drejtës;
- ✚ Stabiliteti politik, ekonomik dhe institucional në vëndin a asociuar, rajonal dhe më gjërë;
- ✚ Institucione dhe kuadër të përshtatëshëm për dialogun politik ndërmjet vëndit të asociuar dhe Bashkimit Europian nëpërmjet zhvillimit të marrëdhënieve të ngushta dhe të besueshme;
- ✚ Thellim të zhvillimit të bashkëpunimit ekonomik reciprok dhe ndërkombëtar, nëpërmjet veçanërisht punës së vëndit të asociuar në përqafimin e legjisllacionit të tij me atë europian dhe ndërkombëtar;
- ✚ Kalimin e vëndit të asociuar nga tranzicioni i tij në zhvillimin ekonomik në një ekonomi shumëfunktionale tregu;
- ✚ Arritje e një zone të lirë të lëvizjes së mallrave, nëpërmjet zhvillimeve graduale të liberalizimit të tregtisë;
- ✚ Rritja e bashkëpunimit rajonal në të gjitha fushat, për të siguruar zhvillim të garantuar dhe të njësuar.

Karakteristikat kryesore të një marrëveshje të stabilizim asociimit, përshkruhen si më poshtë:

- ✚ Reflektim i kriterëve tashmë të vendosura në marrëveshjet e Kopenhagenit dhe Madritit, të cilat kanë zhvilluar dhe rritur Bashkimin Europian;

- ✚ Nevoja për ratifikimin e saj nga të gjitha vëndet, anëtare të Bashkimit Europian si dhe vëndi përfitues;
- ✚ Dialogu politik ndërmjet palëve, me qëllim përcaktimin e qëndrimeve të njëjta për çështjet ndërkombëtare, fqinjësinë e mirë, etj;
- ✚ “Detyrimi” për bashkëpunimin rajonal në të gjitha fushat;
- ✚ Pranimi i marrëveshjes së ripranimit;
- ✚ Pranimi i dispozitave mbi drejtësinë dhe çështjet e brendëshme;
- ✚ Sigurimi i përafrimit të legjislacionit të vëndit përfitues me atë europian dhe veçanërisht me “acquis communitaires;
- ✚ Periudhat tranzitore, të nevojshme për arritjen e asociimit të plotë.

Marrëveshja e stabilizim asociimit synon të sigurojë 4 (katër) liritë themelore, mbi të cilat garantohen themelet e zhvillimit të tregut të brendëshëm të vëndit përfitues. Si të tilla ato përcaktohen:

1. Lëvizja e lirë e mallrave;
2. Lëvizja e lirë e shërbimeve;
3. Lëvizja e njerëzve;
4. Lëvizja e lirë e kapitaleve.

Siç e thamë edhe në hyrje të këtij përshkrimi, pjesa e marrëveshjes së stabilizim asociimit, e cila konsiderohet si marrëveshja e tregtisë së lirë ndërmjet Bashkimit Europian dhe Republikës së Shqipërisë, veçohet nga marrëveshja e përgjithëshme dhe nën titullin “interim”, hyn në fuqi pa pritur ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim asociimit.

Në mënyrë të përmbledhur marrëveshja interim për tregtinë e lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, siguron:

- a. Zbatimin e një tregu të hapur, të ndërtuar sipas parimeve të marrëveshjeve dhe angazhimeve që Republika e Shqipërisë ka me Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT). Po thuajse të gjitha nenet e kësaj marrëveshjeje i referohen nenit XXIV të GATT 94, të cilin po e citojmë më poshtë:

Neni XXIV

Zbatimi Territorial – Trafiku Kufitar – Bashkimet Doganore dhe Zonat e Tregtisë së Lirë

1. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen në territorin doganor metropolitan të palëve kontraktuese gjithashtu dhe në të gjitha territoret e tjera doganore në lidhje me të cilët është pranuar kjo Marrëveshjeje sipas kushteve të nenit XXVI ose që është duke u zbatuar në bazë të nenit XXXIII apo konform Protokollit të Zbatimit Provizor. Secili prej këtyre territoreve doganore do të konsiderohet si të jetë palë kontraktuese, ekskluzivisht për qëllimet e zbatimit territorial të kësaj Marrëveshjeje; Me kusht që dispozitat e këtij paragrafi nuk do të interpretohen së krijojnë të drejta dhe detyrime ndërmjet dy apo më shumë territoreve doganore në lidhje me të cilët kjo Marrëveshjeje është pranuar sipas kushteve të nenit XXVI ose është duke u zbatuar në bazë të nenit XXXIII apo konform Protokollit të Zbatimit Provizor nga një palë e vetme kontraktuese.
2. Për qëllimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, me territor doganor do të kuptohet territori për të cilin mbahen tarifa doganore të ndara apo rregullime të tjera tregtare të ndara për një pjesë domethënëse të tregtisë së saj me territoret e tjera.
3. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të interpretohen për të penguar:
 - a) nga një palë kontraktuese për vëndet kufitare për të lehtësuar trafikun ndërkufitar;
 - b) përfitimet e dhëna në tregtinë me Territoret e Lira të Triestes nga vëndet kufitare të këtij territori, me kusht që këto përfitime nuk janë në kundërshtim me dispozitat e Traktateve të Paqes që vijuan nga Lufta e Dytë Botërore.
4. Palët kontraktuese njohin që është e dëshirueshme rritja e lirisë së tregtisë, duke zhvilluar nëpërmjet marrëveshjeve vullnetare, një integrim më të ngushtë të ekonomive të vëndeve, që janë palë në marrëveshje të tilla. Ato njohin gjithashtu që vëndosja e një bashkimi doganor apo e një zone të lirë tregtare duhet të ketë për objekt lehtësimin e tregtisë ndërmjet territoreve përbërëse dhe jo të vëndosë pengesa në tregtinë e palëve të tjera kontraktuese me këto vënde.
5. Si rrjedhim, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të përbëjnë pengesë, ndërmjet territoreve të palëve kontraktuese, për vëndosjen e një bashkimi doganor ose të një zone të lirë tregtare ose për miratimin e një marrëveshjeje provizore të nevojshme për vëndosjen e një bashkimi doganor ose të një zone të lirë tregtare. Me kusht:
 - a) që, në rastet e një bashkimi doganor ose të një marrëveshjeje provizore të lidhur me qëllim vëndosjen e një bashkimi doganor, tarifat doganore si dhe rregulloret e tjera të tregtisë të zbatuara si pasojë e vëndosjes së këtij bashkimi ose të lidhjes të kësaj marrëveshjeje provizore nuk do të jenë, në tërësinë e tyre, për sa i përket tregtisë me palët kontraktuese të cilat nuk janë palë në të tilla bashkime apo marrëveshjeje, më të larta ose më kufizuese së rritjet e përgjithshme të detyrimeve dhe rregullave të tregtisë që zbatoheshin në territoret përbërëse të këtij bashkimi përpara vëndosjes së bashkimit ose të lidhjes të marrëveshjes, sipas rastit;

- b)* që, në rastet e një zone të lirë tregtare ose të një marrëveshjeje provizore të lidhur me qëllim vëndosjen e një zone të lirë tregtare, tarifaf doganore si dhe rregulloret e tjera të tregtisë të mbajtura në secilin territor përbërës dhe të zbatuara, si pasojë e vëndosjes së zonës së tregtisë së lirë ose e lidhjes të marrëveshjes provizore, në tregtinë e palëve kontraktuese të cilat nuk bëjnë pjesë në një zonë të tillë ose që nuk janë palë në një marrëveshje të tillë, nuk do të jenë më të larta ose ose më kufizuara sesa tarifaf dhe rregulloret e tjera të tregtisë që i korrespondojnë atyre ekzistuese në territoret përbërëse përpara vëndosjes së zonës së tregtisë së lirë ose lidhjes të marrëveshjes provizore, sipas rastit; dhe
- c)* çdo marrëveshje provizore që përmendet në nënparagrafet *a)* dhe *b)* do të përfshijë një plan dhe një program për vëndosjen, në një afat të arsyeshëm, të bashkimeve doganore dhe të zonave të lira tregtare.
6. Në rast se, në përbushje të kushteve të shprehura në paragrafin 5 *a)*, një palë kontraktuese propozon të ngrejë një tarifë doganore në kundërshtim me dispozitat e Nenit II, do të jetë e zbatueshme procedura e parashikuar në Nenin XXVIII. Në përcaktimin e kompensimeve, do të mbahet parasysh kompensimi që rezultojnë nga reduktimet e bëra në tarifaf korresponduese të territoreve të tjera përbërëse të bashkimit.
7. *a)* Çdo palë kontraktuese e cila vëndos të hyjë në një bashkim doganor ose të bëjë pjesë në një zonë të lirë tregtare apo të marrë pjesë në një marrëveshje provizore të lidhur me qëllim vëndosjen e një bashkimi të tillë ose të një zone të tillë, do të njoftojë pa vonesë PALËT KONTRAKTUESE dhe do të sigurojë të gjithë informacionin e disponueshëm për sa i përket bashkimit apo zonës së propozuar, që do t'i mundësojë atyre t'i adresojnë palëve kontraktuese raportet dhe rekomandimet, të cilat ato i gjejnë të përshtatshme.
- b)* Në rast se, pasi të kenë studiuar planin dhe programin e përfshirë në një marrëveshje provizore sipas paragrafit 5, në konsultime me palët e kësaj marrëveshjeje dhe duke marrë parasysh informacionin e dhënë në përputhje me nën paragrafin *a)*, PALËT KONTRAKTUESE arrijnë në konkluzionin që marrëveshja nuk ka të ngjarë që të çojë në vëndosjen e një bashkimi doganor ose të një zone të tregtisë së lirë brenda afateve të parashikuara nga palët kontraktuese në marrëveshje ose që këto afate nuk janë të arsyeshme, PALËT KONTRAKTUESE do të adresojnë rekomandime për palët e marrëveshjes. Palët nuk do të mbajnë në fuqi apo nuk do zbatojnë marrëveshjen, sipas rastit, në rast se ato nuk janë të përgatitura për të modifikuar atë konform këtyre rekomandimeve.
- c)* Të gjitha modifikimet thelbësore të planit apo programit sipas nën paragrafit 5*c)* duhet t'u komunikohen PALËVE KONTRAKTUESE, të cilat mund t'u kërkojnë palëve kontraktuese në fjalë të hyjnë në konsultime me ato, në rast se modifikimet duken se do të kompromentojnë apo do të vonojnë pa të drejtë vëndosjen e bashkimit doganor ose të zonës së tregtisë së lirë.
8. Për qëllimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje,
- a)* me territor doganor do të kuptohet zëvëndësimi i një territori të vetëm doganor me një apo me shumë territore doganore, kur ky zëvëndësim ka për rrjedhojë:
- i)* që detyrimet doganore dhe rregullimet e tjera tregtare kufizuese (me përjashtim, kur kjo do të jetë e nevojshme, të kufizimeve të lejuara sipas neneve XI, XII, XIII, XIV, XV dhe XX) janë eliminuar për pjesën më të madhe të tregtisë ndërmjet territoreve përbërëse të bashkimit, ose të paktën për pjesën më të madhe të tregtisë për produktet që e kanë origjinën nga këto territore; dhe
- ii)* Me kusht zbatimin e dispozitave të paragrafit 9, në pjesën më të madhe zbatohen të njëjtat detyrime doganore dhe rregullime të tjera tregtare nga secili prej vëndëve anëtare të bashkimit doganor për sa i përket tregtisë me territoret të cilat nuk janë përfshirë në bashkim;
- b)* Me zonë të tregtisë së lirë do të kuptohet një grup prej dy ose më shumë territoreve doganore brenda të cilave detyrimet doganore dhe rregullimet e tjera tregtare kufizuese (me përjashtim, kur kjo do të jetë e nevojshme, të kufizimeve të lejuara sipas neneve XI, XII, XIII, XIV, XV dhe XX) janë eliminuar për pjesën më të madhe të tregtisë ndërmjet territoreve përbërëse për sa i përket produkteve që e kanë origjinën në këto territore .
9. Preferencat e referuara në paragrafin 2 të nenit I nuk do të preken nga vëndosja e një bashkimi doganor ose të një zone të tregtisë së lirë; megjithatë ato mund të eliminohen ose të rregullohen në rrugë negociimesh me palët kontraktuese të prekura.* Kjo procedurë negociimi me palët kontraktuese të prekura do të zbatohet, veçanërisht, për eliminimin e preferencave që kërkohet të jenë në përputhje me dispozitat e nën paragrafeve *a)* i) dhe *b)* të paragrafit 8.
10. PALËT KONTRAKTUESE, me një vëndim të marrë me shumicën e dy të tretave, mund të aprovojnë propozimet të cilat nuk janë plotësisht konform dispozitave të paragrafeve 5 deri 9 me kusht që ato të çojnë në vëndosjen e një bashkimi doganor ose të një zone të tregtisë së lirë në kuptimin e këtij neni.
11. Duke marrë parasysh rrethanat e veçanta të cilat rezultojnë nga themelimi i Indisë dhe Pakistanit si Shtete të pavarura dhe duke njohur që këto dy shtete kanë formuar për një kohë të gjatë një bashkësi ekonomike, palët kontraktuese bien dakort që dispozitat e kësaj Marrëveshjeje të mos i ndalojnë këtyre shteteve që të lidhin marrëveshje të veçanta që kanë të bëjnë me tregtinë ndërmjet tyre, në pritje që lidhjet e tyre reciproke tregtare të jenë vëndosur definitivisht.*
12. Secila palë kontraktuese do të marrë të gjitha masat e nevojshme brenda kompetencave të saj në mënyrë që të sigurojë zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nga qeveritë dhe autoritetet rajonale dhe lokale brenda territorit të saj.

- b.* Periudhën tranzitore, e cila garanton krijimin e zonës së tregtisë së lirë ndërmjet palëve, periudhë e cila është përcaktuar 10 (dhjetë) vjet, me dy faza nga 5 (pesë) vjet secila.
- c.* Eliminimin e të gjitha kufizimeve sasiore, apo masave të tjera me efekt të njëjtë;
- d.* Eliminimin e shkallëzuar të tarifave doganore;
- e.* Përafrimin e legjislacionit tregëtar, nëpërmjet harmonizimit të tij me “acquis communitaires”, për të siguruar legjislacion të përshtatshëm dhe modern në fusha si: mekanizmat mbrojtës, dumpingu, masat mbrojtëse të përkohëshme, barrierat teknike në tregti, masat sanitare e firosanitare; mbrojtja dhe zhvillimi i pronësisë intelektuale, etj

- f. Eliminimin e diskriminimit fiskal, për të gjitha llojet e taksave dhe tarifave që zbatohen në territoret e të dy palëve.

Në mënyrë analitike, marrëveshja interim për tregtine e lirë ndërmjet Bashkimit Europian dhe Shqipërisë, përbëhet nga 4 (katër) tituj, si më poshtë:

Titulli i parë:	Parimet e përgjithëshme, përmban 2 (dy) nene, (Neni 1 dhe 2)
Titulli i dytë:	Lëvizja e lirë e mallrave, përmban 1 (nje) nen, (neni 3) dhe 3 (tri) kapituj, si më poshtë:
Kapitulli i parë:	Produktet Industriale, me 7 (shtatë) nene: (neni 4 deri neni 10)
Kapitulli i dytë:	Bujqësia dhe peshkimi, me 8 (tetë) nene: (neni deri neni 18)
Kapitulli i tretë:	Masat e përbashkëta, me 15 (pesëmbëdhjetë) nene: (neni 13 deri neni 32)
Titulli i tretë:	Masat të tjera tregtare, me 10 (dhjetë) nene: (neni 33 deri neni 42)
Titulli i katërt:	Masat institucionale, të përgjithëshme dhe përfundimtare, me 15 (pesëmbëdhjetë) nene: (neni 43 deri neni 57)

Ajo plotësohet me:

- 4 (katër) anekse, si më poshtë:
 - Aneksi I: Tarifat doganore shqiptare për koncensione për produktet industriale nga Bashkimi Europian
 - Aneksi II: Tarifat doganore shqiptare për koncensione për produktet bujqësore nga Bashkimi Europian
 - Aneksi III: Tarifat doganore të Bashkimit Europian për koncensione për produktet shqiptare te peshkut
 - Aneksi IV: E drejta itelektuale, industriale dhe tregtare
- 5 (pese) protokolle, si më poshtë:
 - Protokolli 1: Çeliku dhe produktet e çelikut
 - Protokolli 2: Tregtia në produktet e perpunuar bujqësore
 - Protokolli 3: Produktet e veres dhe pijeve
 - Protokolli 4: Ne lidhje me percaktimet e “produkteve origjinuese” dhe metodave të bashkepunimit administrativ
 - Protokolli 6: Asistenca e përbashkët administrative në fushën e doganave
 - Aktin final
 - 4 (katër) deklarata të përbashkëta
 - 1 (nje) deklaratë nga ana e Bashkimit Europian

Në mënyrë analitike, marrëveshja interim për tregtinë e lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, zberthehet:

Hyrja dhe titulli I, ku mëshirohen parimet e spjeguar në fillim të këtij informacioni, mbështetur në vullnetin dhe angazhimin politik.

Titulli i parë: Parimet e përgjithëshme, përmban 2 (dy) nene, (Neni 1 dhe 2)

Titulli II, Lëvizja e lirë e mallrave

Neni 3, i këtij titulli përcakton këto parime kryesore:

Mbështetja në përcaktimet e OBT-së, veçanërisht neni XXIV i GATT 1994, nomenklatura e kombinuar e klasifikimit të mallrave, mënyra e rrumbullakimit të shifrës së tarifës doganore që rrjedh nga llogaritja e reduktimit të tarifave bazë si dhe parimi *erga omnes*, që angazhon palët që në rastin e uljeve të tarifa bazë që zbaton një vënd, t'i konsiderojë edhe në reduktimet preferenciale të bëra më parë.

Kapitulli i parë: Produktet Industriale, përcakton kuptimin e termit, pra çfarë përfshihen në HS nomenklature (përfshihen produktet e fushës bërthamore) (neni 4).

Neni 5 përcakton eliminimin e të gjitha tarifave doganore, kufizimeve sasiore nga ana e Bashkimit Europian për importet nga Shqipëria.

Neni 6 përcakton mënyrën e eliminimit dhe të reduktimit të tarifave doganore nga ana shqiptare për produktet europiane. Qartësisht përcaktohet që të gjitha tarifat doganore për produktet industriale eliminohen me hyrjen në fuqi të kësaj marreveshje, me përjashtim të disa grupeve të mallrave, të konsideruara të ndjeshme për industrinë shqiptare, tarifat e të cilave reduktohen dhe eliminohen si më poshtë:

ne 80% të tarifës bazë, me hyrjen në fuqi të marrëveshjes

ne 60% të tarifës bazë me 1 janar të vitit të parë, pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes

ne 40% të tarifës bazë me 1 janar të vitit të dytë, pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes

ne 20% të tarifës bazë me 1 janar të vitit të tretë, pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes

ne 10% të tarifës bazë me 1 janar të vitit të katërt, pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes

ne 0% të tarifës bazë me 1 janar të vitit të pestë, pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes

eliminimin e të gjitha, kufizimeve sasiore nga ana shqiptare për importet nga Bashkimi Europian, si dhe (neni 7) eliminimin e të gjitha masave të tjera ekuivalente me tarifat doganore.

Neni 9 parashikon angazhimin e Shqipërisë për të reduktuar më shpejt tarifat doganore, në se një gjë të tillë e lejon zhvillimi ekonomik i vëndit.

Neni 10 parashikon protokollin përkatës për industrinë e çelikut.

Kapitulli i dytë: Bujqësia dhe peshkimi, neni 11 përcakton kuptimin e termit, pra çfarë përfshihen në HS nomenklaturë për produktet bujqësore dhe të peshkimit.

Neni 12 parashikon protokollin përkatës për produktet e përpunuara bujqësore.

Neni 13 parashikon detyrimin reciprok për të dy palët që të eliminojnë me hyrjen në fuqi të marrëveshjes të të gjitha kufizimeve sasiore dhe masave me efekt të njëjtë për produktet e bujqësisë dhe të peshkimit.

Neni 14 ka të bëjë me produktet bujqësore, dhe përcakton që me hyrjen në fuqi të marrëveshjes Bashkimi Europian do të eliminojë të gjitha tarifat doganore, me përjashtim të krereve të HS 01 02 (gjedhe të gjalla); 02 01 (mish i gjedhëve i freskët apo i ftohtë); 02 02 (mish i gjedhëve i ngrirë); 17 01 (Sheqer i prodhuar nga kallam sheqeri apo nga panxhar sheqeri dhe saharoza kimikisht e pastër, në gjëndje të ngurtë); 17 02 (Sheqer tjetër, duke përfshirë laktozën, maltozën, glukozën dhe fruktozën kimikisht të pastra, në gjëndje të ngurtë; shurupet e sheqerit që nuk përmbajnë lëndë aromatizuese dhe ngjyuese shtesë; mjaltë artificial, nëse është apo jo i përzier me mjaltë natyral; karamel) dhe 22 04 (Verë prej rrushit të freskët, përfshirë verërat e pasuruara me alkool; musht rrushi përveç atij të kreut Nr.2009). Po ashtu parashikon që për tarifat doganore të kombinuara ky eliminim për kapitujt 7 dhe 8, do të parashikojë vetëm pjesën që i takon *ad valorem*. Këtu përcaktohen edhe kuota e sheqerit, e mundëshme për t'u eksportuar nga Shqipëria në Bashkimin Europian, pa tarifë doganore, prej 1.000 (njëmijë) tonë.

Më poshtë në këtë nen janë përcaktuar angazhimet e Shqipërisë si më poshtë:

Lista e produkteve të importit, tarifat e të cilave eliminohen me hyrjen në fuqi të marrëveshjes, aneksi II (a),

Lista e produkteve të importit, tarifat doganore të të cilave reduktohen specifikisht siç përcaktohet në këtë aneks, aneksi II (b),

Lista e produkteve të importit, tarifat doganore të cilave reduktohen sipas kuotave të përcaktuara në këtë aneks, aneksi II (c).

Parashikohet gjithashtu në këtë nen edhe protokollin përkatës për verërat dhe pijet.

Neni 15 ka të bëjë me produktet e peshkimit, dhe parashikon angazhimin e Bashkimit Europian për të eliminuar të gjitha detyrimet tarifore për peshkun dhe produktet e peshkut, menjëherë me hyrjen në fuqi të kësaj marreveshje, me përjashtim të disa produkteve të peshkut të freskët dhe atij të konservuar, sipas aneksit III.

Mbështetur edhe në faktin që tarifat që kombi më të favorizuar MFN), mbështetur në angazhimet në OBT gjatë importit në Shqipëri tashmë janë 0%, edhe në këtë nen citohet ky nivel tarifash.

Neni 16 paraqet angazhimin e të dy palëve për të ndërtuar politika të veçanta dhe të përbashkëta në fushën e produkteve bujqësore dhe të peshkimit, si dhe vlerësimin në fund të një periudhe 6 (gjashtë) vjeçare të situatës për të dhënë koncensione më të mëdha për eksportet e produkteve të peshkut, sipas aneksit III.

Nenet 17 dhe 18 vijues parashikojnë bazën e bashkëpunimit dhe mënyrën e veprimit nga palët në rast të problemeve të mundshme që mund të lindin nga zbatimi i marrëveshjes.

Titulli i tretë: Masa të tjera tregtare

Ky kapitull parashikon masat e përbashkëta që duhet të marrin palët për një zbatim korrekt të kësaj marrëveshjeje.

Neni 19 parashikon që këto masa do të zbatohen në të gjithë tregtinë ndërmjet të dy palëve, përveç tregtisë së produkteve të përfshira në protokollet 1, 2 dhe 3.

Neni 20 përcakton detyrimin e palëve për të mos vendosur asnjë tarifë të re doganore në import apo eksport apo masa me efekt të njëjtë me tarifën doganore si dhe asnjë rritje të atyre ekzistuese në tregtinë ndërmjet palëve. Po ashtu asnjë kufizim i ri sasiar në import apo eksport, veç atyre të kësaj marrëveshjeje nuk do të vendosen në tregtinë ndërmjet palëve. Megjithatë në politikën bujqësore seicila palë mund të mos zbatojë angazhimet e mësipërme, nëse regjimi sipas anekseve II dhe III nuk është efektiv.

Neni 21 bën fjalë për ndalimin e diskriminimit fiskal, pra detyrimin e seicilës palë për trajtim të barabartë fiskal të subjekteve, brënda territoreve të tyre.

Neni 22 parashikon që në harmoni me eliminimin e tarifave doganore shkon edhe eliminimi i taksave doganore me natyrë fiskale.

Neni 23 bën fjalë për bashkimet doganore, zonat e tregtisë së lirë dhe mbarëvajtjen në kalimin e kufirit. Këtu parashikohet që çdo iniciativë e ardhëshme për marrëveshje të tregtisë së lirë nga ana shqiptare do të ekzaminohet dhe çertifikohet nga ana e Bashkimit Europian.

Neni 24 flet për dumpingun dhe subvencionet, duke përcaktuar angazhimet për të respektuar rregullat e OBT-së në rast të masave anti dumping apo masave kundër ballancuese.

Neni 25 përcakton masat mbrojtëse të përgjithëshme, në përputhje me përcaktimet e OBT-së, në rastet e dëmtimve serioze të industrive vëndase, kur ka rritje të pa argumentuar të importeve nga palët apo kur ka dëmtime serioze të ekonomive reciproke. Po ashtu janë qartë të përcaktuara mënyra e marrjes së këtyre masave si dhe bashkërendimi ndërmjet palëve për uljen e efekteve negative që vijnë si nga rritja e pakontrolluar e volumeve të importeve ashtu dhe nga efektet në industrinë vëndase.

Neni 26 bën fjalë për mungesat serioze që mund të shkaktojnë efekte veçanërisht në eksport dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre.

Në nenin 27 përcaktohen veçanërisht angazhimet e Shqipërisë për të ulur deri në eliminim të monopolit të shtetit.

Neni vijues 28 jep përfshirjen e protokollit 4, që bën fjalë për rregullat e origjinës preferenciale që palët do të zbatojnë.

Kufizimet e autorizuara janë pjesë e nenit 29, kufizime që lidhen me sigurinë kombëtare, moralin publik, mbrojtjen e shëndetit, jetës së njerëzve, kafshëve dhe bimëve, etj.

Neni 30 parashikon bashkëpunimin administrativ për zbatimin dhe kontrollin e trajtimit preferencial, sipas kësaj marrëveshjeje në fushën doganore. I rëndësishëm është veçanërisht bashkëpunimi në luftën kundër mashtrimit si dhe procedurat e përbashkëta që do të ndiqen në këto raste.

Neni 31 është neni që parashikon mënyrën e funksionimit të Këshillit të Stabilizim Asociimit për zgjidhjen e problemeve të lindura, në rastet e gabimeve të rastit.

Neni 32 përfshin në zbatim të kësaj marrëveshjeje zbatimin e ligjit komunitar për Ishujt Kanary.

Titulli i katërt: Masat institucionale, të përgjithëshme dhe përfundimtare, fillojnë me nenin 33, i cili bën fjalë për trafikun tranzit, përcaktimet, masat e përgjithëshme dhe thjeshtimin e formaliteteve në fushën hekurudhore dhe të rrugëve, për bashkëpunimin dypalësh apo dhe në tranzit. Shprehet gjithashtu angazhimi i palëve për masa të përbashkëta në këtë fushë.

Neni 34 flet për mënyrën miqësore të bashkëpunimit, në fushën e pagesave dhe të transfertave të llogarive korrente dhe bilancit të pagesave, duke ju referuar nenit VIII të marrëveshjes me Fondin Monetar Nderkombëtar.

Në nenin 35 parashikohet sjellja dhe masat për të eliminuar masat kufizuese, por gjithësheu edhe rrugët për të zgjidhur këto probleme në raste të vështirësive serioze të bilancit të pagesave, por gjithmonë sipas rregullave të përcaktuara nga marrëveshjet e OBT-së.

Situatat e mësipërme me një vënd të tretë, jashtë marrëveshjes, nuk detyrojnë palët të zbatojnë rregullat e mesipërme, pasqyrohet në nenin 37.

Në nenin 38 bëhet fjalë për konkurrencën dhe masa të tjera ekonomike. Këtu përcaktohen sjelljet e palëve në këto fusha, angazhimin e palëve për nxitjen e konkurrencës, si dhe për eliminimin e veprimeve të palëve në fushën e eliminimit të konkurrencës.

Në nenin 39 shprehet që Shqipëria, në fund të një periudhe 3 (tri) vjeçare, do të zbatojë mirëkuptimin publik për të drejtat speciale dhe ekskluzive, sipas principeve të traktatit të themelimit të Bashkimit Europian.

Neni 40, Pronësia intelektuale, industriale dhe tregtare, përcakton rëndësinë e këtyre fushave dhe mundësinë e marrjes së masave për të mbrojtur zhvillimet përkatëse. Parashikohet angazhimi i Shqipërisë që jo më shumë se pas 4 (katër) vjetësh të ngrej nivelin e funksionimit të shërbimeve në këto fusha, të ngjashëm me nivelin në Bashkimin Europian. Gjithashtu parashikohet angazhimi i Shqipërisë për të ratifikuar marrëveshje apo konventa ndërkombëtare të kësaj fushe.

Lidhur me kontratat publike flitet në nenin 41 të marrëveshjes interim për tregtinë e lirë. Këtu përcaktohen që palët do të punojnë në mënyrë jo diskriminuese, reciproke dhe sipas kontekstit të OBT-së. Palët do të sigurojnë pjesëmarrje të barabartë, sipas procedurave dhe trajtimeve reciproke në prokurimet publike për kompanitë e vendosura në territorin reciprok. Po ashtu parashikohet edhe procedura për kompanitë që nuk janë akoma të vendosura në seicilin territor reciprok.

Doganat parashikohen në mënyrë specifike në nenin 42 të marrëveshjes interim, ku veçohet ndihma për doganën shqiptare dhe synimi për të harmonizuar legjislacionin doganor shqiptar me *acquis communitaires*. Po ashtu këtu parashikohet edhe zbatimi i protokollit 6, pjesë e kësaj marrëveshje.

Titulli i katërt: Masat përfundimtare, institucionale dhe të përgjithëshme.

Fillojnë me nenin 43, që flet për Komitetit e Përbashkët, themeluar sipas marrëveshjes ndërmjet palëve në 11 maj, 1992 dhe përfshirjen e tij në këtë marrëveshje.

Neni 44 parashikon detyrat kryesore të Komitetit të Përbashkët.

Lidhur me zbatimin dhe interpretimin e kësaj marrëveshje neni 45 ngarkon Këshillin e Stabilizimit dhe Asociimit.

Të drejtat e personave natyrale dhe legale dhe mënyra e mbrojtjes së tyre janë subjekt i nenit 46 të kësaj marrëveshjeje, me synimin e mbrojtjes të tyre individuale dhe të drejtave të pronësisë.

Neni 47 bën fjalë për të drejtat e palëve lidhur me problemet që lidhen me tregtinë e armëve, municioneve, materialeve të luftës, si dhe të kerkimeve, zhvillimeve ose prodhimit të materialeve të domosdoshme të mbrotjes. Por gjithashtu përcaktohen angazhimet e palëve për të punuar për të siguruar paqen, etj.

Mosdiskriminimi ndërmjet vëndeve anëtare të Bashkimit Europian, pjesë të kësaj marrëveshjeje, kombësisë së tyre, shoqërive apo firmave të tyre si dhe reciprokisht për shqiptarët është pjesë e nenit 48.

Bashkëpunimi me vëndet candidate për anëtarësim në Bashkimin Europian parashikohet në nenin 49 të marrëveshjes interim. Po këtu parashikohet edhe fillimi i negociatave për marrëveshje të tregtisë së lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë.

Neni 50 parashikon të drejtën e palëve për të marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Gjithashtu parashikohet veprimi në rastet e jashtëzakonëshme.

Konsultimi në forma të ndryshme lidhur me pyetje apo shqetësime të palës tjetër, që kanë të bëjnë me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje parashikohet në nenin 51.

Neni 52 shprehet për integritetin e kësaj marrëveshjeje me Protokollet 1, 2, 3 4 dhe 6 si dhe anekset I deri III dhe V.

Fillimi i zbatimit të kësaj marrëveshjeje parashikohet në nenin 53.

Neni 54 parashikon zbatimin e kësaj marrëveshjeje në të gjithë territoret që zbatohet traktati i themelit të Bashkimit Europian.

Nenet 55, 56 dhe 57 përcaktojnë institucionet depozituese të marrëveshjes nga ana e Bashkimit Europian, gjuhët, mënyrën e ratifikimit dhe mënyrën e hyrjes në fuqi.

Gjithashtu me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje, marrëveshja e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar, maj 1992, pushon së vepruari.

Marrëveshja vazhdon me deklaratat e përbashkëta si më poshtë:

1. Lidhur me zbatimin e neneve 9 dhe 16, duke shprehur angazhimin e Shqipërisë që në rast të ndonjë impakti me vendet e treta, impakt që rrjedh nga zbatimi i këtyre neneve, duhet të ekzaminohet edhe në Këshillin e Stabilizim Asociimit.
2. Lidhur me zbatimin e nenit 28, që parashikon dhënien e origjinës preferenciale sipas "diagonal cumulation" nga ana e Bashkimit Europian pas vlerësimit nga ana e saj të kushteve.
3. Lidhur me zbatimin e nenit 40, palët angazhohen që për specifikat e "copy right" (veçanërisht programet kompjuterike), të drejtat në "data base", patenta, etj, t'i referohen nenit 10a të Konventës së Parisit.
4. Lidhur me zbatimin e nenit 50, përcaktohen mënyrat e veprimit reciprok në rastet urgjente, por gjithnjë duke respektuar të drejtat e ligjeve ndërkombëtare dhe pa shkelur elementët esenciale të parashikuar në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje.

Deklarata e Bashkimit Europian behet për të përcaktuar faktin që të gjitha preferencat e mundëshme më të mira të dhëna nga regjimi i tanishëm autonom që Bashkimi Europian i ka akorduar Shqipërisë mbeten në zbatim edhe me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Për sa i përket përmbajtjes së anekseve, në mënyrë të përmbledhur parashtrojmë se:

Aneksi I, koncensionet shqiptare për produktet industriale: përfshin produkte të tilla si: kripa e gjellës, çimento, karburantet, plehurat fosfatike, sapun, detergjente, plastikat, gomat e përdorura, lëkurët, hekurin e ndërtimit, tullat e tjegullat, shampot, tubat me saldim, mobiljet e drurit. Reduktimi tarifor do të jete gjatë periudhës tranzitore, si më poshtë:

në 80% të tarifës bazë, me hyrjen në fuqi të marrëveshjes

ne 60% të tarifës bazë me 1 janar të vitit të parë, pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes

ne 40% të tarifës bazë me 1 janar të vitit të dytë, pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes

ne 20% të tarifës bazë me 1 janar të vitit të tretë, pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes

ne 10% të tarifës bazë me 1 janar të vitit të katërt, pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes

ne 0% të tarifës bazë me 1 janar të vitit të pestë, pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes

Aneksi II(a), koncensionet shqiptare për produktet bazë bujqësore, pa tarifa doganore, pa kuota tarifore, përfshin produkte si: kafshët e gjalla, të të gjitha llojeve; mish i kuajve, gomerëve dhe të brendëshmet e tyre; pemët dhe bimët e gjalla; farat e zarzavateve dhe disa zarzavate të freskëta, si çikore, etj; arra kokosi, bajame në guackë dhe pa guackë, banane të thara, greifrut, rrush pa afara, stafidhe, rrush frëngu i zi, manaferra, kajsi, lëkurë agrumesh; lëkurët e kafesë, arra hindi; grurë për mbjellje, oriz, melekuqe, hikërr dhe mel; miell tërshëre, bollgur, tërshërë, miell prej lëkurave leguminoze, niseshte; kokrra soje, kikirikë, kopra, fara liri; lidhës gome, opium; dhjamra të ndryshme, vajra të të gjitha llojeve; të brendëshmet e mishit të përpunuara, ekstraktet dhe lëngjet e mishit; sheqer, glukozë dhe malasat; lëvozhga kakao; brumra të mbushura; disa lloj zarzavatesh të konservuara, si këpurdha, zarzavate, fruta,

arra, lëkura frutash dhe pjesë të tjera të bimëve, Fruta, arra lajthi bajame dhe pjesë të tjera të ngrënëshme të bimëve, të përgatitura apo të ruajtura ndryshe, nëse përmbajnë apo jo sheqer apo lëndë të tjera embëlsuese shtesë apo alkool, disa lloj lëngje frutash; koncentre proteinash; pije të tjera të fermentuara; miellra nga mishi, peshku, etj, krundet, mbetje të niseshtesë, bërsi të ndryshme, materiale vegjetale, ushqime kafshësh; duhan i papërpunuar; vajra esenciale, përzierje aromatike; tutkall kaseine, xhelatine, peptonë dhe dirivate; lëkurët e papërpunuara; gëzofët e papërpunuara; mëndafshi; leshi;pambuku; liri.

Aneksi II(b), koncensionet shqiptare për produktet bazë bujqësore, me reduktim tarifor gjatë periudhës tranzitore, përfshin produkte si: kuaj, gomerë të gjallë; të tilla të ngrira; disa lloje produkte qumështi, kosi; qimet e njerëzve dhe të kafshëve; trëndafilat, karafilat; patate për niseshte, qepë të njoma, sallatë marule, rrepa, selino, kastravecacat e vegjël, perime leguminoze, angjinare, patate dhe perime leguminoze të ngrira, perime të ruajtura përkohësisht në ujë ose gaz sulfuror; produkte të thara si arra, bajame, etj; kafe, piper, disa fara frutash, disa lloj erëzash, miell thekre; përgatitje të homogjenizuara; sheqer të aromatizuara, etj; kokrra kakao; perime të përgatitura apo të ruajtura ndryshe nga në uthull apo në acid acetik, bërsitë dhe mbetje të tjera të forta, llum vere, bërsi materialesh vegjetale. Reduktimi tarifor do të jete gjatë periudhës tranzitore, si më poshtë :

në 90% të tarifës bazë, me hyrjen në fuqi të marrëveshjes

në 80% të tarifës bazë me 1 janar të vitit të parë, pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes

në 60% të tarifës bazë me 1 janar të vitit të dytë, pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes

në 40% të tarifës bazë me 1 janar të vitit të tretë, pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes

në 0% të tarifës bazë me 1 janar të vitit të katërt, pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes.

Aneksi II(c), koncensionet shqiptare për produktet bazë bujqësore, me kuota, përfshin produkte si: 20.000 (njëzet mijë) tonë miell gruri dhe misri.

Aneksi III, koncensionet e Bashkimit Europian për peshkun dhe produktet e peshkut, me kuota reduktim tarifor, përfshin produkte si:

Trofta, kuota 50 (pesëdhjetë) tonë, pa tarifë doganore. Mbi këtë sasi:

me 90% të tarifës bazë, me hyrjen në fuqi të marrëveshjes,

80% të tarifës bazë në vitin e parë pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes dhe

70% në vitin e dytë pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes.

Krapi, kuota 20 (njëzet) tonë, pa tarifë doganore. Mbi këtë sasi:

me 90% të tarifës bazë, me hyrjen në fuqi të marrëveshjes,

80% të tarifës bazë në vitin e parë pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes dhe

70% në vitin e dytë pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes.

Peshk i ujrave të embla, kuota 20 (njëzet) tonë, pa tarifë doganore. Mbi këtë sasi:

me 80% të tarifës bazë, me hyrjen në fuqi të marrëveshjes,

55% të tarifës bazë në vitin e parë pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes dhe

30% në vitin e dytë pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes. (Nje grup kodesh HS)

Peshk i ujrave të embla, kuota 20 (njëzet) tonë, pa tarifë doganore. Mbi këtë sasi:

me 80% të tarifës bazë, me hyrjen në fuqi të marrëveshjes,

me 55% të tarifës bazë në vitin e parë pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes dhe

me 30% në vitin e dytë pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes. (Një grup tjetër kodesh HS)

Sardele konserva, kuota 100 (njëqint) tonë në vit me tarifë doganore 6%, ad valoreum.

Acuge konserva, kuota 1000 (njëmijë) tonë me tarifë doganore 0%, me një rritje vjetore të kuotës prej 200 (dyqint) tonë, nëse arrihet të eksportohet mbi 80% të kuotave të një viti më parë, deri në 1600 (njëmijë e gjashtëqint) tonë.

Mbi të gjitha këto sasi aplikohet tarifa e plotë doganore.

Për të gjithë produktet e tjera të klasifikuara në kodet 1604, do të zbatohet reduktim tarifor si më poshtë:

në 80% të tarifës bazë, me hyrjen në fuqi të marrëveshjes,
në 65% të tarifës bazë në vitin e parë pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes dhe
në 50% në vitin e dytë pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes.

Aneksi V, E drejta e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare. Përfshin të gjithë konventat e nënshkruara nga palët në këtë marrëveshje si dhe angazhimet për të ratifikuar edhe konventa të tjera, të listuara në këtë aneks. Po ashtu përcaktohet edhe angazhimi shqiptar për njohjen e të drejtës komunitare ndaj pronësisë intelektuale.

Protokolli 1, për hekurin dhe produktet e çelikut. Përbëhet nga 7 (shtatë) nene, të cilat përcaktojnë:

Neni 1 përcakton produktet që përfshin ky protokoll.

Neni 2 përcakton eliminimin e të gjitha tarifave doganore nga ana e Bashkimit Europian për produktet e këtij protokoll.

Neni 3 përcakton skedulën e reduktimit të tarifave për produktet e çelikut, përfshirë në aneksin I dhe eliminimin e të gjitha tarifave doganore për produktet e papërfshira në aneksin I.

Neni 4 përcakton eliminimin reciprok të të gjitha kufizimeve sasiore dhe masa me efekt të njëjtë nga data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Neni 5 parashikon nevojën dhe detyrën e ristrukturimit të kësaj industrie, në përputhje me konkureshmërinë globale të kësaj industrie. Shqipëria, brënda 3 (tri) vjetësh nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje do të hartojë programin e ristrukturimit të kësaj industrie, nën kushtet normale të tregut. Pas 5 (pesë) vitesh nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje Shqipëria duhet të heqë të gjitha ndihmat shtetërore në këtë sektor.

Neni 6 përcakton se nenet 20, 21 dhe 22 të marrëveshjes mund të zbatohen edhe në tregtinë e çelikut.

Protokolli 2, për tregëtinë në sektorin e produkteve të përpunuara bujqësore, përbëhet nga 3 (tri) nene.

Neni 1, përcakton tarifatat që do të zbatohen për produktet e përpunuara bujqësore, sipas anekseve I, II(a), II(b), II(c) dhe II(d), ku përcaktohen edhe mënyrat e reduktimit.

Neni 2 përcakton se si mund të reduktohen këto tarifa në të ardhmen.

Angazhimin e palëve për të informuar lidhur me arrangimet administrative për produktet nën këtë protokoll.

Aneksi I, produktet që do të importohen në Bashkimin Europian pa kuota dhe pa tarifa doganore, përcaktohen si më poshtë:

Kos dhe disa nënprodukte qumështi; shpërndarje bulmetore; flokët e njerëzve, qimet e kalit, lëkurët e zogjve, kockat dhe palmet e brirëve, fildishi, koralet, sfungjeri natyral, qelibari; misër i ëmbël i gatuar; mate; leshterikët dhe alga të tjera; lëngje xhamballi, kulpre; materialet vegjetale të një lloji të përdorur kryesisht për thurje; yndyrë leshi e substancat yndyrore të rrjedhura prej tyre, dhjamra e vajra të tjera me origjinë prej kafshëve e fraksionet e tyre; yndyrna të tjera të fiksuara vegjetale, yndyrna me origjinë prej kafshëve apo vegjetale dhe fraksionet e tyre, margarinë; përzierjet apo përgatitjet e ngrënëshme të vajrave dhe dhjamrave vegjetale, vajra e dhjamra prej kafshëve apo vegjetale e fraksionet e tyre, glicerina, bruto; ujrata glicerinë dhe finjat glicerinë, dyllet vegjetale (përveç treglycerideve), dyll blete, dyll dhe spermacetë të tjera të insekteve, nëse janë apo jo të rafinuar apo të ngjyrosur, degjas; mbetjet e rezultuara nga përpunimi i substancave yndyrore apo i dylleve vegjetale apo prej kafshëve; embëlsirat prej sheqerit (përfshirë çokolatën e bardhë), që nuk përmbajnë kakao, brum kakao, nëse është apo jo e ç'ndyrosur, gjalp kakao, yndyrë apo vaj kakao, pluhur kakao, që nuk përmban sheqer apo lëndë të tjera embëlsuese shtesë, çokolatat dhe përgatitje të tjera ushqimore që përmbajnë kakao; ekstrakt malti; përgatitjet ushqimore prej miellit, kokrrizave, niseshtëse apo ekstraktit të maltit, që nuk përmbajnë kakao, brumrat nëse janë apo jo të gatuar apo të mbushur (me mish apo me substanca të tjera) apo të përgatitur ndryshe, të tilla si spageti, makarona, makarona petë, lasanje, gnocchi, ravioli,

kaneloni; couscous nëse janë apo jo të përgatitur, tapioka dhe zëvendësuesit e tij përgatitur nga niseshtëja, në formën e fetëzave, kokrrave, margaritarëve, tophash apo në forma të ngjashme, ushqimet e përgatitura fituar prej bymimit apo pjekjes së drithrave apo të produkteve të tyre (për shëmbull, fetëza drithi); drithrat (ndryshe nga misri (si drith)) në formë kokrrë apo në formë fetezash apo kokrra të punuara ndryshe (përveç miellit e kokrrizave të miellit), të para-gatuara apo të përgatitura ndryshe, buke, torta, kek, biskotat dhe produkte të tjera të furrtarit, nëse përmbajnë apo jo kakao; nafore, hapet (kapsulat) bosh të një lloji të përshtatshëm për qëllime farmaceutike, vaferet me shtresa, leter orizi dhe produkte të ngjashme; zrazavate në uthull si misër i ëmbël, pate dhe zemër palme, etj; ekstrakte, esenca e koncentre të kafesë, çajit apo matesë e përgatitjet me bazë të këtyre produkteve apo me bazë të kafesë, çajit apo matesë; çikore e pjekur e zëvendësuesit e tjerë të pjekur të kafesë, dhe ekstraktet, esencat dhe koncentratet prej tyre, maja (aktive apo joaktive); mikro-organizmat e tjera një qelizore të vetme, të ngordhura; pluhura të përgatitura për ardhjen e brumrave, salcat dhe përgatitjet prej tyre; erëza të përzierja dhe aromatizues të përzier; miell dhe kokrriza mielli mustarde dhe mustarde të përgatitur, supat dhe lëngjet e mishit si dhe përgatitjet prej tyre; përgatitjet ushqimore të përbëra të homogjenizuara, akulloret dhe akuj të tjera të ngrënëshëm, nëse përmbajnë apo jo kakao, përgatitje ushqimore; ujra, përfshirë ujrë minerale natyrale apo artificiale e ujrë e gazuar, që nuk përmbajnë sheqer apo lëndë të tjera embëlsuese apo aromatizuese shtesë; akulli dhe bora, ujrë, përfshirë ujrë minerale e ujrë e gazuar, që përmbajnë sheqer apo lëndë të tjera embëlsuese apo aromatizuese shtesë, dhe pije të tjera jo-alkoolike, birra bërë nga malti, vermuth dhe verëra të tjera prej rrushit të freskët aromatizuar me bimë apo me substanca aromatizuese, alkool etilik jo i denaturuar i një force alkoolike ndaj volumit prej 80 % vol apo më e lartë; alkool etilik dhe alkool të tjera, të denaturuara, të çdo lloj force, pije të fituara nga distilimi i verës së rrushit apo të bërësive të rrushit, puro, cigare dhe cigarillos, prej duhanit apo prej zëvendësuesve të duhanit, duhan tjetër i përpunuar e zëvendësuesit e përpunuar të duhanit; duhan i "homogjenizuar" apo i "rindërtuar"; ekstrakte dhe esenca prej duhanit, alkoolët aciklike dhe derivatet e tyre, të halogjenizuara, të sulfonatuara, të nitratuara apo të nitrosaturuara, vajrat esenciale (të terpentuara apo jo), përfshirë vajrat "konkrete" e "absolute"; rezinoidet; oleoesinat e ekstraktuara; koncentratet e vajrave esenciale në formë yndyre, vaji yndyror, në formë dylli apo në forma të ngjashme, të fituara nëpërmjet procesit të zbutjes apo procesit të heqjes së esencave; nënproduktet terpenike të fituara nëpërmjet procesit të deterpentimit të vajrave esenciale; distilatet ujore dhe solucionet ujore të vajrave esenciale, përzierjet e substancave aromatike dhe përzierjet (përfshirë solucionet alkoolike) me bazë të një apo me shumë të këtyre substancave, të një lloji të përdorur si lëndë e parë në industri; preparatet e tjera të bazuara në substancat aromatike, të një lloji të përdorur për prodhimin e pijeve, kaseine, kaseinatet dhe derivatet e tjera prej kaseines; tutkall kaseine, dekstrinat e niseshtëtë e tjera të modifikuar (psh, niseshtëtë e esterefikuar apo të paraxhelatinuara); ngjitësat e bazuara në niseshtëtë, apo mbi dekstrinat apo mbi niseshtëtë e tjera të modifikuar, agjentet ilustrues, agjentet mbajteset e bojës për të shpejtuar ngjyrosjen apo fiksimin e bojrave dhe produkte dhe preparate të tjera (për shëmbull, materialet lidhëse dhe fiksuere), të një lloji të përdorura në industrinë e tekstilit, të letrës, lëkurës apo në industri të ngjashme, acidet yndyrore monokarboksilike industriale; vajrat acide nga rafinimi; alkoolët industriale yndyrore, lidhësit e përgatitur për format apo kallëpët apo zemrat në fonderi; produktet kimike e preparatet kimike të industrive kimike apo të lidhjeve (përfshirë ato që konsistojnë në perzierje të produkteve natyrale).

Aneksi II (a), produktet që do të importohen në Shqipëri pa kuota dhe pa tarifa doganore, përcaktohen si më poshtë:

Flokët e njerëzve, qimet e kalit, lëkurët e zogjve, kockat dhe palmat e brirëve, fildishi, koralet, sfungjeri natyral, qelibar i hirtë, kastori, zibet dhe myshku; cantharides; vreri, nëse është apo jo i tharë; gjëndrat dhe produkte të tjera me origjinë prej kafshëve të përdorur në përgatitjen e produkteve farmaceutike, mate, lëngje dhe ekstrakte vegjetale; substanca pektike, pektinatet dhe pektatet; agar-agar e lëndë të tjera ngjitëse e trashëse, nëse janë apo jo të modifikuar, të rrjedhura nga produktet vegjetale, materialet vegjetale të një lloji të përdorur kryesisht për thurje

(psh, bambunë, palmën indiane, kallamat, shelgu, gjethet e drurit të palmës, kashtë drithi, e pastruar, e zbardhur apo e lyer dhe levorja e lirit), yndyrë leshi e substancat yndyrore të rrjedhura prej tyre (duke përfshirë lanolinën), yndyrna me origjinë vegjetale dhe fraksionet e tyre. margarinë; përzierjet apo përgatitjet e ngrënëshme të vajrave dhe dhjamrave vegjetale apo prej kafshëve apo të fraksioneve të yndyrnave të ndryshme, vajra e dhjamra prej kafshëve apo vegjetale e fraksionet e tyre, të ziera, të oksiduara, të dehidratuara, të sulfurizuara, të shkrira, të polimerizuara nga nxehtësia në vakum ose në gaz inert apo ndryshe të modifikuara kimikisht; përzierjet apo përgatitjet e pangrënëshme të vajrave e dhjamrave vegjetale apo prej kafshëve apo të fraksioneve të yndyrnave, glicerina, bruto; ujrata glicerinë dhe finjat glicerinë, dyllet vegjetale (përveç treglicerideve), dyll blete, dyll dhe spermace të tjera të insekteve, nëse janë apo jo të rafinuar apo të ngjyrosur, degreas; mbetjet e rezultuara nga përpunimi i substancave yndyrore apo i dylleve vegjetale apo prej kafshëve, sheqer tjetër, duke përfshirë laktozen, maltozën, glukozën dhe fruktozën kimikisht të pastra, në gjëndje të ngurtë; shurupet e sheqerit që nuk përmbajnë lëndë aromatizuese dhe ngjyuese shtesë; mjalte artificial, nëse është apo jo i përzier me mjalte natyral; karamel, ëmbelsirat prej sheqerit (përfshirë çokollatën e bardhë), që nuk përmbajnë kakao, brum kakao, nëse është apo jo e ç'ndyrosur, gjalp kakao, yndyrë apo vaj kakao, pluhur kakao, që nuk përmban sheqer apo lëndë të tjera embëlsuese shtesë, tapioka dhe zëvendësuesit e tij përgatitur nga niseshtëja, në formën e fetëzave, kokrrave, margaritarëve, tophash apo në forma të ngjashme, bukë, torta, kek, biskotat dhe produktet e tjera të furrëtarit, nëse përmbajnë apo jo kakao; naforet, hapet (kapsulat) bosh të një lloji të përshtatshëm për qellime farmaceutike, vaferet me shtresa, leter orizi dhe produktet e ngjashme; ekstrakte, esenca e koncentrate, të kafesë, çajit apo matesë e përgatitjet me bazë të këtyre produkteve apo me bazë të kafesë, çajit apo matesë; çikore e pjekur e zëvendësuesit e tjerë të pjekur të kafesë, dhe ekstraktet, esencat dhe koncentratet prej tyre, salcat dhe përgatitjet prej tyre; erëza të përziera dhe aromatizues të përzier; miell dhe kokrriza mielli mustarde dhe mustarde të përgatitur, supat dhe lëngjet e mishit si dhe përgatitjet prej tyre; përgatitjet ushqimore të përbëra të homogjenizuara, përgatitje ushqimore, duhan tjetër i përpunuar e zëvendësuesit e përpunuar të duhanit; duhan i "homogjenizuar" apo i "rindërtuar"; ekstrakte dhe esenca prej duhanit; alkoolët aciklike dhe derivatet e tyre, të halogjenizuara, të sulfonatuara, të nitratuara apo të nitrosaturuara; vajrat esenciale (të terpentuara apo jo), përfshirë vajrat "konkrete" e "absolute"; rezinoidet; oleoresinat e ekstraktuara; koncentratet e vajrave esenciale në formë yndyre, vaji yndyror, në formë dylli apo në forma të ngjashme, të fituara nëpërmjet procesit të zbutjes apo procesit të heqjes së esencave; nënproduktet terpenike të fituara nëpërmjet procesit të deterpentimit të vajrave esenciale, përzierjet e substancave aromatike dhe përzierjet (përfshirë solucionet alkoolike) me bazë të një apo më shumë të këtyre substancave, të një lloji të përdorur si lëndë e parë në industri; preparatet e tjera të bazuara në substancat aromatike, të një lloji të përdorur për prodhimin e pijeve, kaseinë, kaseinatet dhe derivatet e tjera prej kaseinës; tutkall kaseine, dekstrinat e niseshtetë e tjera të modifikuara (psh, niseshtetë e esterefikuar apo të paraxhelatinuara); ngjitësat e bazuara në niseshtetë, apo mbi dekstrinat apo mbi niseshtetë e tjera të modifikuara; agjentët ilustrues, agjentët mbajtëset e bojës për të shpejtuar ngjyrosjen apo fiksimin e bojrave dhe produktet dhe preparatet e tjera (për shëmbull, materialet lidhëse dhe fiksuese), të një lloji të përdorura në industrinë tekstilë, të letrës, lëkurës apo në industri të ngjashme, acidet yndyrore monokarboksilike industriale; vajrat acide nga rafinimi; alkoolët industriale yndyrore, lidhësit e përgatitur për format apo kallëpet apo zemrat në fonderi; produktet kimike e preparatet kimike të industrive kimike apo të lidhjeve (përfshirë ato që konsistojnë në përzierje të produkteve natyrale),

Aneksi II (c): produktet që do të importohen në Shqipëri pa kuota por me reduktim tarifor gjatë periudhës tranzitore, përcaktohen si më poshtë

Misër i ëmbël, çokollatat dhe përgatitje të tjera ushqimore që përmbajnë kakao, ekstrakt malti; përgatitjet ushqimore prej miellit, kokrrizave, niseshtesë apo ekstraktit të maltit, që nuk përmbajnë kakao apo që përmbajnë kakao ndaj peshës më pak se 40% të llogaritur mbi një bazë totalisht të ç'ndyrosur, të paspecifikuara e të papërfshira diku tjetër; përgatitjet ushqimore të mallrave të krereve Nr.0401 deri 0404, që nuk përmbajnë kakao apo që përmbajnë kakao ndaj peshës me

pak se 5 % të llogaritur mbi një bazë totalisht të çyrdyrosur, brumrat nëse janë apo jo të gatuar apo të mbushur (me mish apo me substanca të tjera) apo të përgatitur ndryshe, të tilla si spageti, makarona, makarona pete, lasanje, gnocchi, ravioli, kaneloni; couscous nëse janë apo jo të përgatitur, ushqimet e përgatitura fituar prej bymimit apo pjekjes së drithrave apo të produkteve të tyre (për shëmbull, fetëza drithi); drithrat (ndryshe nga misri (si drith)) në formë kokrrë apo në forme fetëzash apo kokrra të punuara ndryshe (përveç miellit e kokrrizave të miellit), të paragatuara apo të përgatitura ndryshe, zarzavatet, frutat, arrat dhe pjesë të tjera të ngrënëshme të bimëve, të përgatitura apo të ruajtura në uthull apo në acid acetik, ekstrakte, esenca e koncentre të kafesë, çajit apo matesë e përgatitjet me bazë të ketyre produkteve apo me bazë të kafesë, çajit apo matesë; çikore e pjekur e zëvendësuesit e tjerë të pjekur të kafesë, dhe ekstraktet, esencat dhe koncentratet prej tyre, maja (aktive apo joaktive); mikro-organizmat e tjera një qelizore të vetme, të ngordhura; pluhura të përgatitura për ardhjen e brumrave, salcat të përgatitjet prej tyre; erëza të përziera dhe aromatizues të përzier; miell dhe kokrriza mielli mustarde dhe mustarde të përgatitur, akulloret dhe akuj të tjera të ngrënëshëm, nëse përmbajnë apo jo kakao, ujra, përfshirë ujrat minerale natyrale apo artificiale e ujrat e gazuar, ujrat, përfshirë ujrat minerale e ujrat e gazuar, që përmbajnë sheqer apo lëndë të tjera ëmbëlsuese apo aromatizuese shtesë, dhe pije të tjera jo-alkoolike, birra, puro, cigare dhe cigarillos, prej duhanit apo prej zëvendësuesve të duhanit, duhan tjetër i përpunuar e zëvendësuesit e përpunuar të duhanit; duhan i "homogjenizuar" apo i "rindërtuar"; ekstrakte dhe esenca prej duhanit. Në këtë aneks përcaktohen se vetëm birra bëhet me tarifë 0%, me hyrjen në fuqi të marrëveshjes, kurse për të gjithë produktet e tjera, tarifa reduktohen si më poshtë:

Nëe 90% të tarifës bazë, me hyrjen në fuqi të marrëveshjes

Në 80% të tarifës bazë me 1 janar të vitit të parë, pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes

Në 60% të tarifës bazë me 1 janar të vitit të dytë, pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes

Në 40% të tarifës bazë me 1 janar të vitit të tretë, pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes

Në 0% të tarifës bazë me 1 janar të vitit të katërt, pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes.

Aneksi II (d): Produktet e mëposhtëme do të importohen në Shqipëri duke j'u nënshtruar tarifave të plota doganore. Produktet janë:

Produkte të qumështit, salcat dhe përgatitjet prej tyre; erëza të përziera dhe aromatizues të përzier; miell dhe kokrriza mielli mustarde dhe mustarde të përgatitur.

Protokolli 3, Konkensionet reciproke preferenciale për verën si dhe mbrojtja reciproke dhe kontrolli për emrat e verës, pijeve dhe verës aromatike

Është një protokoll shumë teknik, që përmban 2 (dy) nene dhe 2 (dy) anekse.

Aneksi 1, si marrëveshje për konkensionet reciproke preferenciale për verën, sipas të ciles pa tarifa do eksportohen nga Shqipëria në Bashkimin European 7000 (shatë mijë) HI verë, kurse do të importohen 10000 (dhjetë mije) HI

Aneksi 2, bën fjalë për marrëdhëniet teknike për mbrojtjen reciproke dhe kontrollin për emrat e verës, pijeve dhe verës aromatike.

Së fundi pjesë e marrëveshjes interim për tregtinë e lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit European janë protokollat për bashkëpunimin dhe administrimin doganor dhe rregullat preferenciale të origjinës.

Duhet theksuar se kjo pjesë ka një volum shumë të madh dhe është shumë teknik.

Në të përcaktohen kushtet kur import eksporti i mallrave përfiton nga reduktimet tarifore sipas marrëveshjes, dokumentacioni që shoqëron këtë lëvizje mallrash nën regjimin preferencial, etj.

Ilir KODRA

Tiranë, më 08.05.2006